



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Ministria e Diasporës – Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

---

## DEPARTAMENTI I POLITIKAVE TË DIASPORËS

### PROJEKT

#### FINALJA E KUIZIT TË DITURISË “TA NJOHIM ATDHEUN”

**Prishtinë**

**(2013)**

Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me subjekte të tjera në diasporë (mësuesit e SHSHMP-së, këshillat e prindërve etj.), si edhe në Kosovë, në kuadër të takimeve tashmë tradicionale “DITËT E MËRGATËS NË KOSOVË 2013”, e organizon finalen e kuizit /konkursit/ të diturisë “Ta njohim atdheun” 2013 dhe e ndihmon mbajtjen e kuizeve në vendet e ndryshme, në bazë të kërkesave të tyre.

#### 1. Qëllimet themelore do të mund të përcaktoheshin si:

- a) Edukimi për identitetin/në të gjitha shtresat e tij /dhe kultivimin e tij , krenarinë e origjinës;
- b) Edukimi për dijen dhe përfitimi i saj nëpërmjet garave “si lojë” didaktike ;
- c) Lidhje dhe ndërveprime të tjera faktorësh e subjektsh qeveritare e civile në funksion të mbështetjes së fëmijëve të mërgatës;
- d) Sensibilizimi i shoqërisë në të gjitha segmentet e saj për nevojën e shtimit të përgjegjësisë së përkujdesjes më dinamike ndaj mërgatës/posaçërisht ndaj brezit të ri dhe vetëdijes e identitetit të tij kulturor e kombëtar;
- e) Njohje dhe ndërkomunikime dinamike.

## **2. Përmbajtja /baza kurrikulare:**

- Kurrikula e SHSHMP-së në diasporë (dokumenti i MASHT-it të Kosovës 2007);
- Përfshihen fushat identitare: gjuha dhe letërsia shqipe, historia dhe gjeografia e atdheut;
- Artet (skenike, pamore, etj.) dhe trashëgimia kulturore materiale e shpirtërore e atdheut.

## **3. Kritere e standarde themelore:**

Pyetjet i harton grupi profesionist. Për nxitjen e mendimit logjik dhe shmangien e skemave memorizuese, rekomandohen pyetje me përgjigje të sakta brenda alternativave. Ekipit i shtrohen 8 pyetje, nga 2 për fushë. Përgjigjet dhe vlerësimin e bën juria profesioniste prej 3 anëtarësh. Skenarët e pyetjeve, edhe në trajtë të shkruar, ekipet i tërheqin me short. Pyetjet, si sllajde multimediale , projektohen edhe në ekranin publik, në mënyrë që të sigurohet transparenca e plotë. Drejtimin e koordinimin e veprimeve e bën moderatori profesionist, i cili vepron prej skenës.

Televizioni publik (RTK, ose ndonjë tjetër) duhet ta xhirojë emisionin dhe, më pas, ta transmetojë në termin të pranueshëm. Efektet do të ishin mjaft inkurajuese e motivuese, veçanërisht për shtimin e shkallës së përfshirjes së fëmijëve në SHSHMP në diasporë .

## **4. Koha dhe vendi**

Në Prishtinë, korrik 2013; xhirimet nga RTK-ja ose nga një televizion tjetër nacional.

## **5. Garuesit /pjesëmarrësit**

Ekipet fituese garash në vende të ndryshme, ku zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare gjatë vitit shkollor 2012/13.

Ministria e Diasporës subvencionon organizimin e kuizeve në vendet ku organizohen ato dhe i heq të gjitha shpenzimet për finalen që mbahet në Prishtinë.

### **Koha dhe vendi**

Në Prishtinë më 20 korrik 2013 në ora 17:00, regjistrohet nga RTK-ja, ose një televizion nacional.

Ekipet pjesëmarrëse në finale e kuizit duhet ta konfirmojnë pjesëmarrjen më së voni deri më 25 qershor 2013.